
 Republika e Kosovës Republika Kosovo	Zyra e Personelit		 Komuna e Istogut Opština Istok
	02 Nr 46/21	22.06.2021	

Në mbështetje të nenit 67 dhe 68 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, si dhe nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, Komuna e Istogut shpall:

K O N K U R S

Institucioni: Komuna e Istogut

Drejtoria: Drejtoria për Administratë Komunale

Titulli i vendit të punës: Roje Laure në Autoparkun e Komunës

Numri i pozitave : 1 (një)

Lloji i Pozitës: Niveli Administrativo-Mbështetës

Titulli i Mbikëqyrësit: Udhëheqësi i Sektorit Administrativ

Grada/Koeficienti: Koeficienti 5

Orët e Punës: 40 orë në javë

Periudha e Kontratës: Në kohë të pacaktuar

Kohëzgjatje e periudhës provuese: Gjashtë (6) muaj

Përshkrimi i detyrave dhe Përgjegjësi:

1. Kontrollon dhe monitoron autoparkun e komunës ;
2. Është përgjegjës për mirëmbajtjen , dhe funksionimin e laurës;
3. Kontrollon dhe verifikon çdo hyrje dalje të automjeteve zyrtare ;
4. Ndalon parkimin e automjeteve të tjera pa lejen e eprorit të cilit i përgjigjet;
5. Pas përfundimit të orarit të punës, ju dorzon në gjendje të rregullt rojes së objektit dhe e njofton me numrin e automjeteve;
6. Kryen punë dhe detyra tjera të parashtruara nga mbikëqyrësi, Udhëheqësit të Sektorit dhe Drejtorit të AK.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Të drejtë për konkurim - punësim kanë të gjithë personat e moshës madhore të cilët kanë zotësi për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgaditjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë për kryerjen e detyrave të punës.

Kualifikimi profesional, aftësitë:

- Përgaditja shkollore e mesme, përvojë profesionale së paku 3 vite;
- Shkathësi të shkelqyeshme të komunikimit në gjuhën zyrtare;
- Aftësi për të hartuar informatë, njoftime, shkresa dhe korrespondencë tjetër.

Dokumentet e kërkuara:

- Dëshmia përkatëse për posedimin e diplomës së shkollës së mesme;
- Dëshmi të përvojës së punës;
- Dy rekomandime;
- Letërnjoftimi;
- Ekstrakti nga libri amë i të lindurve;
- Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende (të Punësuarit)
- Çertifikata që nuk jeni nën hetime

Konkursi mbetet i hapur: *8 ditë 22.07.2021 prej datës deri 30.07.2021.*

Kandidatët e interesuar aplikacionet mund ti marrin në formë fizike, çdo ditë pune, në Qendrën për Shërbime me Qytetar, dhe të plotësuara ti dorëzojnë në Qendrën për Shërbime me Qytetarë, zyra nr.100- kati i parë, në ndërtesën e Komunës.

Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret dhe hynë në listën e ngusht do të ftohen në intervistë. Diploma duhet të jetë e noterizuar, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë të plotësuar këtë kusht të konkursit.

Mirëpritën aplikacionet prej meshkujve dhe femrave të të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës

Aplikacionet e dorzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e pakompletuara refuzohen.

Rezultatet shpallen në web faqe e komunës dhe linkun <https://konkursi.rks-gov.net/>